

KOQVARIJA

Ballina: Albina Kelmendi

**Gozhdët
mund të hiqen
a birat jo**


**Në Kosovë
bie nataliteti,
shtohen qentë**

**Çka pritet
nga brezi që rri
zgjuar natën
a fle ditën**

**Nazmi Viqa:
Femra do të jetë
prioritet i zhvillimit
të UB-së**

**ALBINA
KELMENDI**

*Këngëtarja
24 karatë*



SHTËPIA NUK ËSHTË NJË
VEND, ËSHTË NJË
NDJENJË



DINO
QERAMIKA

Në ballinë

Ka lindur me yll në ballë, për të shkëlqyer kudo, në çdo skenë. Kjo është Albina Kelmendi, artistja e artë që e push-ton publikun kudo ku shfaqet e këndon. Këndon me zemër, le copëza shpirti në çdo paraq- itje dhe kjo është arsye- ja më e fortë që publiku e do, madje shumë. Në “Kos- ovare” ballë për ballë me Albinën për muzikën dhe karri- erën e saj...

**ALBINA
KELMENDI**

*Këngëtarja
24 Karatë*



Albinë, nga fëmijëria jote çka do të veçoje a çka do kishe bërë ndryshe?

- Oh, më mungon! Mbase për faktin se ndoshta kam dal nga fëmijëria para kohe, para gjeneratës sime.

Angazhimet e mia të hershme e kanë kufizuar jetën time femijërore...

Por, nëse flasim për vitet e fëmijërisë deri në kohën kur unë nisa rrugëtimin tim, sigurisht që ato vite janë më të ëmblat dhe më mungon ajo kohë të cilën çdo fëmijë e shijon në liri, jetë pa detyrime dhe obligime që tanimë janë vetëm nostalgji imja.

Dihet se fillimi i muzikës që në fëmijëri ka qenë ndoshta ndikimi nga ambienti familjar, meqë e dimë se rrjedhë nga një familje muzikantësh. Na intereson të dimë se cili ishte inspirimi yt që t'i përkushtohesh në tërësi muzikës?

- Ambienti në të cilin jeton, rritesh dhe zhvillohesh është indikator i rëndësishëm në ndërtimin e personalitetit. Por, ajo që më mban dhe më inspiron për të vazhduar tutje është ndjenja që jap dhe marrë nga muzika dhe interpretimet e mija muzikore.

Ishit finaliste në "The voice of Albania", por nuk u nderuat me vendin e parë. Çka fituat në "The voice..."?

- Çdo person, kur nis rrugën e konkurimit apo të përballjeve me konkurrencën, synon pikën më të lartë, pra vendin e parë. E, unë nuk arrita, por në muzikë më vonë kuptova se ajo është vetëm një statistikë dhe asgjë më shumë, për faktin se unë fitova respektin dhe zemrën e publikut, gjeta shumë adhurues të këngës, e këtë e dëshmon fakti ku jam sot...

Andaj, nga "The voice..." fitova më të mirën, atë që çdo këngëtar synon, pra publikun.

A u mungon një spektakël i tillë?

- Të këndosh apo të ngjitesh në skena profesionale, para publikut të gjerë, e sidomos atij medial, është ndjenjë e veçantë.

Andaj, spektaklet profesionale, si, bie fjala, "The voice..." më mungojnë dhe jo vetëm mua, por gjithë atyre që kanë dëshirë ta shprehin talentin e tyre...

Fatkeqësisht, spektaklet e tillë mungojnë, ku me dëshirë do dilja në skena të tilla...

Çfarë mendon se e bën një këngëtar a këngëtare të mirë?

- Konsideroj se një këngëtar, që të jetë i suksesshëm, përveç talentit, punës dhe përkushtimit, duhet, në veçanti, ta ketë origjinalitetin dhe synimet e tij të caktuara.

Ke karrierë të suksesshme. Cili, sipas teje, është suksesi yt i deritashëm?

- Mendoj se çdo këngëtar është personalitet në vete, në shërbim të popullit në aspektin kulturor, në këtë rast të atij muzikor. Andaj, ruajta e traditës dhe avancimi i saj, është një ndër shtyllat që unë konsideroj se për vete i kam në nivelin më të mirë.

E, respektimi i asaj se çfarë dëshiron publiku nga ti, është element i rëndësishëm i karrierës dhe i mbajtjes së nivelit të një këngëtari.

Pra, siç thashë edhe më lart, origjinaliteti është shtylla më e fortë imja.

Cila këngë mendon se të ka afruar me publikun dhe cilën e këndon me shpirt?

- Interpretimi i këngëve buri-more, në një variant apo stil tjetër muzikor, janë këngë të cilat më kanë ofruar më se shumti me publikun.

Andaj, çdo këngë të mirëpritur a të dëshiruar nga publiku e këndon me shpirt e dashuri.

Njiheni këngëtare e muzikës "live". Krenari, kënaqësi, apo sfidë?

- Po, me dashuri dhe dëshirën më të madhe do këndoja vetëm "live", mirëpo në studio kam problem të këndoj, meqë nuk jam para publikut.

Është krenari, sepse vetëm në të kënduarit "live" dalin në pah vlerat muzikore artistike të një këngëtari.

E, kënaqësi është sepse jep e merr ndjenjën dhe emocionin më të çmuar në këngë.

Ndërkaq, sfidë është sepse në masë të madhe mungon shumë gjetja e hapësirës së interpretimit të muzikës së gjallë.

Por, sot dihet se muzika elektronike "usb muzike" është mënyra më e lehtë e krijimit të zhurmës muzikore.

Si ndjehesh kur këndon këngë popullore?

- Më parë thashë se këngëtari i takon popullit, andaj ndihem e lumtur dhe krenare që këtë e bëj mirë dhe me shumë dashuri...

Ku është Albina tash dhe "Family Band"?

- Çdo kund ku është Albina është dhe "Family Band"! Sepse, e ndjej veten të sigurt me "Family Band", e rrethuar nga muzikantë, këngëtarë të spikatur e me përvojë.

"Nanë moj, kam gabu" është projekti yt më i ri. Pak më shumë për këtë projekt dhe pse ai titull?

- Pothuajse qe një kohë të gjatë jam shkëputur në lansimin e këngëve të mija për publikun. E, kur e them këtë, fjalën e kam në këngët autoriale të mijat.

"Nanë moj, kom gabu", është

një nga këngët e shumta që janë duke pritur në folderët e mi për publikim.

Arsyeja e publikimit të kësaj kënge është e ndërlidhur me gjendjen apo problemet shoqërore e sociale dhe koha e lanasmit të saj është e lidhur me fushatën dhe mesazhin kundër drogës, siç e kam potencuar edhe në publikimin e videoklipit.

Pra, nuk ka të bëjë me asgjë personale, por është një pretendim imi që nëpërmjet artit muzikor të përcjellë mesazhin që të rinjtë të jenë sa më larg dukurive që çojnë në rrugë të këqija.

Çka presim nga ju në të ardhmen e afërt?

- E, çka pritet nga këngëtarët përveç këngëve të reja e të mira, e që unë, pa mëdyshje, ua premtoj që tani?!

Por, ajo që e vlen të theksohet dhe të njoftohet publiku im është fakti se tani, në këtë kohë, unë dhe "Family Band" jemi të angazhuar dhe të përkushtuar tërësisht në prezantimin tonë për "Festivalin e Këngës 61" në Radiotelevizionin Shqiptar, me pretendime në përzgjedhjen e përfaqësimit të Shqipërisë në "Eurovizion".

E presim edhe mbështetjen e publikut...

Kujt i thua faleminderit për të gjitha?

- Faleminderit Zotit për çdo gjë që e gëzoj sot! Për talentin, për familjen time që më qëndrojnë afër në të mirë e në të keq, për publikun që më mban dhe sigurisht edhe për bashkëshortin tim që më fal veç lumturi dhe më bën ta ndjej veten edhe më të fuqishme krahë tij!

Nderim Neziri



Pritje për viza

50 mijë vetë në vit e lëshojnë Kosovën!

Ndonëse flitet e përflitet se Kosovën po e braktisin të rinjtë, politika zyrtare nuk e qartëson këtë akt social të rinisë sonë...

Këto ditë rastisa të dalë në fushë futbollit, në cilësinë e referit, meqë në fshat e formuan një ekip që do të garojë në ligë për të synuar tutje...

Mendoja sa shumë të rinj do të vijnë e do të shtyhen në fushë për të luajtur. Sepse, kështu ka qenë dikur, kur ne luanim futboll. Ndodhnin edhe rrahje mes të rinjsh për një vend loje në fushë.

Dhe, me pa durim e prisja ndeshjen, me shpresë së do të mbushej stadiumi me të rinj...

Por, mezi u bën dy ekipe nga Gadimja me 2000 shtëpi!

Nuk qenka si dikur, thashë me vete...

Gjërat paskan ndryshuar. Por, kjo nuk është rastësi, sepse në tërë lagjen time, e që i ka mbi 50 shtëpi, ishte vetëm një djalë 20 vjeç, të cilin e shihja çdo mëngjes kur shkonte në shitore me blerë bukë.

Por, ka dy muaj që edhe ai më nuk shihet.

Dëgjova se ka shkuar në Gjermani.

Andaj, më nuk ka djem të rinj që kanë mbetur në lagje.

E, kështu, si është gjendja tash, as që është e nevojshme heqja e vizave. Sepse, më s'ka të interesuar për viza...

Sidoqoftë, ditë më parë më qiti puna në një poligon të autoshkollave, ku përgatiten kandidatët për shofer.

"A thua, të gjithë i kanë marrë patentë-shoferët?!", e pyes tim mik, që i ushtron kandidatët për shofer.

"Më shumë ka femra sesa meshkuj", më thotë ai dhe vazhdon: "Meshkujt po këqyrin si me ikë nga Kosova, e nuk po u intereson patentë-shoferi".

Të nesërmen, para marketit "Special" në fshatin tim, në Gadime të Lipjanit, ndalon një veturë. Del shoferi. Ai është pronar i një gurëthyesi dhe kërkon punëtorë me pagë goxha të mirë...

Tregon se ka mbetur pa punëtorë në gurëthyes. E, nuk ka as bagerist, sepse ka kohë që bageristi i kishte shkuar në Gjermani...

Dhe, nëse e krahasojmë të kaluarën e afërt, kur në fshat para çdo shitoreje qëndronin dhjetëra të rinj, duke u argëtuar me muhabet e pije, tashmë nuk ka të tillë, sepse, sipas statistikave, 50 mijë vetë çdo vit e lëshojnë Kosovën!

Nuk ka më badihaxhij, e që kohën e kalojnë në rrugë. Të gjithë kanë ikur në Perëndim.

SHQIPTARËT IKIN NË PERËNDIM, NË KOSOVË VIJNË NGA BANGLADESHI!

Se shqiptarët e Kosovës ikin për në shtete të Evropës kurse në Kosovë vijnë nga Bangladeshi, nuk është dezinformatë. Pra, Gjermania po e merr brezin e ri, të aftë për punë, e në Kosovë vijnë njerëz nga

Bangladeshi, që nuk na duhen asgjë...

Dhe, kush e ka projektuar këtë politikë sociale ende nuk dihet, por po flitet se duhet në Kosovë të ndryshojë struktura etnike, pasi shqiptarët janë bërë pengesë për Serbinë, për Evropën, për botën.

Andaj, shtrohet pyetja: A thua, a do të vjen ajo kohë që të huajt të na komandojnë, siç ndodhi, bie fjala, në Angli, ku kryeministri i Qeverisë së Anglisë u emërua njeriu me ngjyrë?

23 VJET PAS LUFTE - ENDE PUNËT PUS!

U bën 23 vjet pas lufte e shteti nuk ka siguruar as pensione meritore, sigurime shëndetësore, mbrojtje në punë dhe, për më keq, në këtë krizë ekonomike nuk ta japin as ndonjë përqindje nga trusti pensional, edhe pse ato para janë të djersës tënde!

Cilido që synon qeverinë premton e premton, kurse kur ta merr "timon" del më i keq se ai që ishte para tij!

Andaj, në këso rrethanash, shumëkush më nuk dëshiron të jetojë në Kosovë. Sepse, ka kaluar koha kur binim dhe zgjoheshim nga gjumi me emrin Kosovë...

E, brezi i ri nuk e ka përfjetuar një gjë të tillë dhe nuk i intereson patriotizmi i dikurshëm. Ai dëshiron të jetojë mirë dhe të ketë standard evropian.

Safet Krivaça

GOZHDËT MUND TË HIQEN A BIRAT JO!



1.

Një plak, para se të vdiste, i afroi djemtë dhe u tha nga përvoja e vet: Në jetë njeriu duhet t'i mbajë me vete gjithmonë tri gjëra: Një metër, një guri dhe një gjilpërë.

E pse këto? – e pyetën djemtë. – Pse ta mbajë metrin me vete?

Plaku u përgjigj: Ta mat vendin ku do të ulet në mesin e të tjerëve.

E gurin pse?

Ta peshojë fjalën e vet para se të flasë.

Po gjilpërën?

Ta thumbojë veten para se t'i thumbojë të tjerët... – u gjejg plak.

2.

Njani e kish pas një djal të mbrapshtë dhe nuk lente të zezë pa ba në katund. Nisën njerëzit po i vijjnë në derë dhe i ankoheshin: "O filan, djali yt ma bani këtë të keqe..."

Plaku, tue mos pas çka me i ba, filloi që për çdo të keqe të djalit që e bante e ngulte nga një baski (gozhdë) në derën e kullës. Kur u mbushë dera me gozhda, plak u thirri t'birin e po e bën dert këtë punë.

Djali ishte rritë dhe e kuptoi se ç'kishte ba.

Atëherë vendosi me u përmysue dhe iu drejtue babës: "Babë, prej sot po ta jap fjalën se njerëzit kanë me ardh me t'u falënderue për t'mirat që do t'i baj tash e tutje".

Dhe, ashtu ndodhi. Plaku për çdo punë të mirë

të djalit filloi ta hiqte nga një gozhdë nga dera e kullës. Kur u hoqën të gjitha, djali erdhi e po lavdërohej para babës për këto vepra. Plaku, atëherë ia ktheu:

"More bir, gozhdat u hoqën, por kanë mbetur birat! E ato, pasha babën, nuk mbyllen bash kollaj..."

3.

Nji zot shpije, i nji familjeje të madhe, qohet e shkon te hoxha.

"Kam ardh me ma shkruie nji hajmali", i thotë hoxhës.

"Hajrli koftë, o burrë! Po, për kë ashtu?"

"Për robtë e shpisë teme".

"Pse, çka kanë?", e pyet hoxha.

"Janë tranue valla, s'di çka me ba me ta!"

"Sa rob jeni?", e pyeti hoxha.

"Me mue tridhjetë e shtatë", i gjejg burri.

"Ani mirë", i thotë hoxha dhe ia shkruan hajmalinë.

"Këtë hajmali veç ti baje dhe kurrkush mos ta sheh!", i drejtohet hoxha tue ia dhanë hajmalinë.

"Jo, bre hoxhë, unë se kam për veti, po të tregova për robtë e shpisë, për familjen", ia ktheu burri pak i revoltuar.

"Jo valla, burrë, ti mbaje se katërdhjetë rob të trent e i zoti i shpisë me kanë me mend, kjo nuk ban vaki hiq!"

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Rilinda Krasniqi

Ardita Dili

Dizajni:

Labinot Bërbotovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

Nëna që e bëri fëmijën kurban në kohë lufte

Vitet 1998-1999 ishin vitet e krimit më monstruoz të Serbisë në Kosovë, e veçmas në Drenicë. Dhe, në këtë kuadër, forcat serbe, gjatë një ofensive pranë Polacit, kishin granatuar popullatën për të futur këmbësorinë paramilitare. Dhe, ç'ndodhi?

Një nënë me vete i kishte dy fëmijët binjakë. Ishin nga një vjeç kur filluan granatimet afër Polacit në Drenicë. Dhe, teksa iknin nga granatimet, i bie afër një predhë granate dhe ajo e lëshon njërin binjak në arë, për ta shpëtuar tjetrin, sepse më nuk i kishte mbetur fuqi të ikte... Por, po në ato çaste, një grua e moshuar ecte pas saj. Dhe, kur ajo e lë në arë binjakun e merr plaka, qëllimisht që ta shpëtonte nga granatimet...

Por, në atë tollovi të krijuar, nëna iku me njërin binjak në krah, u fut në kolonën e njerëzve për të mësyre Shqipërinë.

SI E VAZHDOI PLAKA JETËN ME FËMIJËN NJËVJEÇAR?

Plaka, grua që e mori në arë binjakun tjetër, ishte e moshuar dhe e pafuqishme ta ndiqte kolonën e njerëzve që kishin mësyre Shqipërinë, andaj vendoset në njërën nga shtëpitë e djegura që ishin afër. Por, çka t'i jepte fëmijës njëvjeçar për të mbijetuar?

Bukë nuk kishte, andaj plaka i ofrohet një lope që kulloste në afërsi të varrezave dhe nis të mjelë, t'ia merr qumështin për fëmijën e gjetur në arë. Kështu, i siguroi ushqim fëmijës, i cili edhe nisi të përmirësohej nga shëndeti i ligë. Ndërkohë, nëna e binjakëve, sipas shënimeve në kampin e Kukësit, kishte arritur të shkonte në Suedi dhe nuk dinte gjë për fëmijën e lënë në arë...

Por, një natë kishte parë ëndërr se fëmija i saj binjak ishte gjallë... Andaj, edhe vendosë të kthehet në vendlindje, për ta kërkuar fëmijën e lënë në arë... Dhe, me të ardhur në shtëpi kishte takuar njerëz që ishin sado pak në dijeni se ku

mund të jetë i biri i saj binjak. Andaj, ditë pas ditësh kishte arritur ta takojë gruan që e mbante fëmijën e saj...

LOTËT RRËKE TË PLAKËS...

Plaka, teksa merrte thupra gardhi për të pjekur bukën, u pyet nga një grua tjetër nëse dinte për një fëmijë që ishte lënë në kohë lufte në ara.

"Loke, a je e këtij vendi?", e pyet ajo.

"Po", përgjigjet plaka.

"A mos di gjë për një fëmijë që e ka lënë një nënë në ara, në kohë lufte?"

"Kush je ti?", e pyet plaka.

"Jam nëna e atij fëmije. Nuk munda t'i mbaja të dy në krahë dhe e lashë njërin, pa u hamendur se do të vuaj kudo që të jem", ia kthen gruaja e vuajtur.

Dhe, pasi hyjnë në shtëpi, plaka kalon në dhomën tjetër dhe e zgjon fëmijën nga gjumi.

Nëna e përlotur i ofrohet fëmijës së vet, e që tashmë ishte tre vjeç, por fëmija struket në prehër të plakës.

Megjithatë, edhe pse e kishte fëmijën para vetes, nuk u besonte syve se e kishte gjetur binjakun tjetër.

E, në anën tjetër, plakës i shkonin lotët rrëke...

S. M.



★★★★★
BREZOVICA
HOTEL & SPA



PREMIUM SUITE

1 Queen Bed
Private Jacuzzi in balcony



DELUXE SUITE

1 Queen size bed & sofa
1 King Bed
Jacuzzi & fireplace



**Hotel for
every type of vacation**

sales@brezovica-hotel.com or call +383 49 30 10 30
www.brezovica-hotel.com

Jetoj mirë a nuk punoj asgjë!

I vogël është numri i të rinjve që punojnë, e edhe më i vogël i atyre që nga paga e tyre e mbajnë familjen, në krahësim me numrin e madh të atyre që gjatë tërë ditës i sheh teksa shëtisin me duar në xhepa ose rrinë në kafene me orë të tëra... Dilema është: Si jetojnë dhe si e planifikojnë jetën të rinjtë e sotëm?

E vërteta është se shumë të rinj, veçmas vajzat, përtrojnë të punojnë, kurse dëshirojnë të jetojnë mirë dhe të rrinë me orë të tëra në kafene me makiato përpara, me veshje ekstravagante dhe me modën më të fundit!

Pra, jetojnë mirë a nuk punojnë asgjë!

**VALËVITA, 24 VJEÇE,
NGA PRISHTINA:
PO MË MBAJNË PARATË
QË I KAM KURSYER NG
PUNA NË DUBAI**

- Kam punuar një kohë manekine në Dubai dhe ende po më mbajnë paratë që

i kam kursyer. Momentalisht, po rri dhe jam në pritje se mos po ma vazhdojnë kontratën edhe për një vit, e kjo do më shpëtonte materialisht, por edhe psikikisht, sepse nuk po rrihet pa punë, ani pse xhepat i kam plot...

Nganjëherë nuk po më rrihet në shtëpi, andaj dal me shoqe dhe ulemi në kafene dhe me makiato përpara flasim, nga një herë edhe për tema krejt pa lidhje...

**KIMETJA, 31 VJEÇE,
NGA FUSHË-KOSOVA:
FRANGAT PO MË VIJNË
SI PREJ QIELLIT!**

- Nuk kam nevojë të punoj, sepse falë Zotit vëllezërit i kam në Zvicër dhe frangat më vijnë si prej qiellit!

Jetoj mirë dhe i kam të gjitha... Ka kohë që e kam marrë patentë-shoferin dhe me veturë po ia theri me të fejuarin tim herëherë edhe në Shqipëri. Sepse, as i fejuari im nuk punon dhe s'po dimë si ta kalojmë kohën...

**ARLINA, 25 VJEÇE,
NGA HAJVALIA:
PUNOVA DERI NË DITËN
KUR PRONARI NISI T'MË
VARDISEJ!**

- Një vit punova në një butik dhe më pëlqente puna që bëja, sepse nuk ishte punë e rëndë, por edhe i merrja nga 300 euro në muaj dhe sa për vete kisha para

mjaft.

Dhe, do të rrija aty edhe shumë vjet po të mos ndodhte ajo që nuk e prisja nga pronari i butikut ku punoja. E, aq më keq, ai ishte i martuar dhe kishte fëmijë! Dalëngadalë filloi t'më provokonte dhe në fund më tha troç: Nëse do pranoja të isha dashnorja e tij do ma rriste rrogën... Andaj, po atë ditë i thashë: M'i jep paratë për ditët që kam punuar gjatë muajit se po më duhen me e dërguar nesër nënën në kontroll te mjeku...

Dhe, ai, duke më besuar, m'i dha paratë për punën që kisha bërë dhe në mbrëmje, kur arrita në shtëpi, e thirra në telefon dhe e falënderova për mundësinë që ma kishte dhënë të punoja te ai, por që nga dita e nesërme më nuk jam e interesuar të punoj. U habit dhe, teksa nisi të kërkoj sqarim nga unë, ia mbylla telefonin dhe me aq përfundoi edhe ai muhabet.

**SI TA PËRMBYLL
KËTË TEMË?**

Ka të rinj e të reja që kanë nevojë të punojnë, sepse jeta është bërë e shtrenjtë dhe nuk i dilet dot në krye. Por, ka edhe të tillë që nuk dëshirojnë të punojnë, meqë i kanë kushtet e mira në familje dhe të tillët bredhin poshtë e lart që ta kalojnë ditën. Por, e mira e së mirës do të ishte që gjithsecili të kishte mundësi të punonte dhe të siguronte vetë kafshatën e gojës, sepse buka e tjetrit nuk të mbanë ngitë gjithmonë...

Diturie Haxhaj

remos® KA PUNË PËR TY!



Çka ne po kërkojmë është: Pizzamen, Kuzhinier, Barista, Kamarier



Aplikuesit duhet të kenë njohuri të gjuhës
Gjermane dhe Angleze

Vendndodhja:
Frankfurt, Köln, Koblenz, Wiesbaden,
Westerwald, dhe Urmitz.

Na kontaktoni në info@remos-restaurants.de



[remos_restaurants](https://www.instagram.com/remos_restaurants)

| info@remos-restaurants.de

| www.remios-restaurants.de

Oda ku rrinte këmbëkryq **Brahim Grainca**

*Kthehesha nga kur-
beti, i përmallur për
odën dhe shtëpinë
dhe për të tjerët që
e përbënin jetën
time. Oda ishte ndër-
tuar njëmbëdhjetë
vjet para vitit 1900
dhe kishte kaluar
një shekull sfidash
dhe sulmesh për të
arritur vitin 2000,
fillimin e shekullit
njëzetën timer.*

Nuk kisha udhëtuar me tren, sikur atë ditë që e lashë në vetmi odën e vjetër, por kthehesha me aeroplan në tokën e lirë. Por, kur arrita, nuk e shoh si dikur odën e tre shekujve. E gjithë lagjja kishin hedhur bërllok në afërsi të saj dhe oda ishte shndërruar në gërmadhë. Tjegullat i kishin mbetur mbi drunjtë e bungut që i kishte gdhendur me kujdes

gjyshi, para se të burgosej nga sistemi i atëhershëm.

Në atë kohë halla e kishte marrë primatin e shtëpisë dhe kujdesin ndaj saj, duke i punuar tridhjetë hektarë tokë. E veshur me xhamadan e tirq të zinj, e kishte vazhduar fuqinë e shtëpisë derisa të kthehej vëllai i saj nga burgu.

NUK PËRGJAKET PRAGU I ODËS PA U PËRGJAKUR UNË!

Disa fëmijë loznin afër odës, teksa unë i ofrohem me lot malli.

I zoti i saj ka vdekur në luftë. Jo nga plumbi i shkaut, por nga pleqëria. Ja kishte plotësuar Zoti dëshirën të vdiste në kohë lufte, që do t'i jepte fshisë qëndrimin të Serbisë në Kosovë.

Muret nuk ishin shkatërruar, por vende-vende ishin mbuluar pas rënies së pullazit brenda odës.

Trapazani i dikurshëm, në të cilin babai i mbante drutë për ngrohje të odës, nuk ishte më, sepse ishte mbuluar nga tjegullat.

Isha i vogël kur mbahej një pajtim. Mbi qilimat e kuq burrat ishin ulur në të dy anët e odës, që dukeshin si dy taborë luftimi. Flisnin njerëzit gjaknxehtë, sepse nuk merreshin vesh për një hektar tokë. Më të dobët donin t'ia merrnin tokën, duke ja ndarë në dy pjesë arën me një rrugë të

panevojshme!

Njëri prej burrave i tha: "A po e jep tokën sa nuk është përgjakur pragu i kësaj ode!". Babai u ngritë në këmbë e i tha: "Kjo është oda ime, o jaran! Nuk mund t'i përgjaket pragu pa u përgjakur unë, sepse jeni në besë! Por, tokën me zor nuk mund t'ia merrni, sepse është e tij dhe pikë". Dhe, u përmbyllë ai problem...

NJERI QË FLISTE VEÇ PËR BASHKIMIN ME SHQIPËRINË...

E, në një rast tjetër, po në këtë odë që tash është mbuluar nga tjegullat e barishtet, ishte baca Brahim Grainca, i cili në çdo ndejë temë kryesore e kishte bashkimin me Shqipërinë.

E tash, ti po dergjesh, oda ime! Je shndërruar në gërmadhë...

I zoti të ka vdekur, oda ime, ndërsa ti po dergjesh si një gërmadhë...

Sot je larg historisë dhe sikur ke dëshirë ta rikthesh kohën e shkuar të besës e burrërisë...

E, kalamajtë që lozin afër teje nuk dinë për vlerat që i ke pasur dikur. Nuk dinë sa herë t'i kanë shkëlur shkallët dhe qilimat e kuq armiqtë me çizme deri në gjunjë...

I zoti yt do të gëzohej po ta dinte se tash, i biri i tij, po të shikon me dhembje, me keqardhje që je shkatërruar nga koha...

Sokol Murturi



Për libër të Ginisit

Në Kosovë bie nataliteti, shtohen qentë!

Sot, në këtë fundjavë pune, teksa vija në Redaksi, në qendër të Prishtinës, në sheshin “Zahir Pajaziti”, ku bën pjesë edhe oborri i Hotelit “Grand”, më shumë hasa në qenë endacakë sesa në njerëz që shkonin në punë apo që kishin dalë të pinin kafe! Por, qenë endacakë ka me shumicë edhe kudo nëpër Prishtinë, madje edhe në skutat e saj...

Me ardhjen e KFOR-it në Kosovë, nuk kishte qenë endacakë, sepse ushtarët e KFOR-it i vrisnin. Ma vranë edhe “Galoshin” tim në fshat, sepse kishin hasur në të natën, teksa patrullonin. Thënë të drejtën mu dhimbtë shumë, se në vitin 1999, kur i lëshuam shtëpitë tona nga dhuna serbe, “Galoshi” erdhi pas nesh deri në fund të fshatit. Dhe, kur pa se ne po ecim tutje ai me vrap u kthye në shtëpi...

Në fund të qershorit, kur u ktheva nga Shqipëria ku isha refugjat, posa hyra në oborr më hetoi, vrapoi drejt meje dhe këmbët e para i hodhi në gjoks tim.

Dhe, pa dyshim, e përqafova shumë, se më kishte marrë malli për të...

Por, sot, pas 23 vjetësh të asaj kohe, çdo ditë lexojmë lajme se si qentë e sulmuan këtë e atë fëmijë dhe e bëjnë

për spital, kurse ndaj qenve endacakë nuk ndërmerret asgjë!

Shteti as nuk i vret e as nuk i mban në strehimoret publike, kurse ndalon vrasjen e tyre!

Pra, qeni ka të drejtë të të kafshojë, të të shqyejë, t’i bëjë fëmijët sakat, kurse askush nuk ka të drejtë t’i vrasë!

PSE TË MOS IA LË RRUGËS SIME EMRIN E “GALOSHIT?”

Të shtunën që shkoi shkova në varrezat e fshatit, për t’i vizituar varret e prindërve.

Por, temën po e qes diku tjetër...

Përreth rrugës së asfaltuar janë pesë varre. Ato kanë një histori në vete, e që lidhen me ngjarjet e vitit 1945. Pesë vetë janë vranë shkaku i mynafirllëkut të një njeriu, emri i të

cilit figuron në tabelën e kaltër, në krye të rrugës që qon kah lagja ku ka jetuar ai.

Pesë vetë janë vranë shkaku i spiunimit të tij, që i kishte informuar rrethëm ballistët se gjoja filani po merret me komunistët dhe partizanët. Spiuni kishte raportuar çdo natë te ballistët, për t’u rënë në derë fqinjëve të tij, pa pasur ata asnjë lidhje me komunistët e as partizanët! Qëllimi i tij ishte që fëmijëve të tyre t’ua merrte tokat... Shkurt, tash një rrugë e lagjes e mban emrin e tij! Pra, të njeriut i cili la pesë varre pas...

Eh, thashë me vete, pse një rrugë të fshatit tim të mos i lihet emri i “Galoshi” tim, i cili e mbrojti oborrin e shtëpisë edhe atëherë kur ne nuk ndodheshim në të?

S. Krivaça

Unioni i bizneseve shqiptaro-gjermane

Nazmi Viqa: Femra do të jetë prioritet i zhvillimit të UB-së

*Unioni i Bizneseve me
Degë organizative edhe
në Stuttgart*

Me datën 11.11.2022 në Fellbach/Stuttgart, u themelua Dega e Unionit të Bizneseve për Republikën Baden Württemberg. Prezente në takim ishte Kryetari me pjesën dërmuese të Kryesisë së Unionit të Bizneseve shqiptare – gjermane në Gjermani. Kryetari i UB, z. Nazmi Viqa duke i përshëndetur të pranishmit, dhe falenderuar për pjesëmarrjen, paraqiti disa pika të strategjisë së re të UB, ku theks i veçant do t'i jepet shtrirjes së saj në tërë territorin e Gjermanisë, duke ju afruar secilit anëtar. Derisa identifikimi dhe kycja e afaristeve Femra, do të jetë prioritet i zhvillimit të UB. Në takim të pranishëm ishte edhe Konsulja e përgjithshme e Republikës së Kosovës, zonj. Lumturie Lipoveci, me Konsujt Besnik Miftaraj dhe Gramoz Berisha. Zonja Lipoveci shprehi knaqësinë që takon biznese shqiptare, anëtare të UB me fuqi të theksuar këtu në Gjermani dhe me potencial investiv në Vendlindje, disa nga të cilët tanimë vetëm se janë prezent në Kosovë me investimet e tyre. Ofroi bashkëpunim institucional për të gjitha Bizneset që dëshirojnë të investojnë në Kosovë. Nen kryetari, z. Gani Nuha, kërkoi nga bizneset shqiptare në Gjermani t'i bashkojnë forcat për projekte të përbashkëta në Gjermani dhe Vendlindje. Edhe Nen kryetari, z. Zenun Krasniqi, dhe anëtarët tjerë të Kryesisë, Villaznim Kel-



mendi e Nexhmedin Veliqi, me diskutimet dhe prezencën e tyre u angazhuan për rritjen dhe fuqizimin e mëtutjeshëm të UB. Pas prezentimit të objektivave, formës së re organizative dhe sfidave e prinzipave të UB nga drejtori ekzekutiv, z. Fadil Abdulahu, u bë edhe prezentimi i Kryesisë së re të UB për Baden Württemberg. Kryesia e re e emëruar, përbëhet nga:
– z. Besim Preniqi, kryetar
– zonj. Njomza Sheqiri, nënkryetare
– z. Afrim Osmanaj, nënkryetar
Kryesia e re e emëruar, duke e falenderuar Kryetarin dhe Kryesinë për besimin e dhënë, u zotua se me stafin operativ do të

punoj ngusht që të jetë zëri reprezentues i secilit biznes të kësaj ane. Ishte për tu përshëndetur numri i madh i afaristave pjesëmarrës në takim dhe interesimi i tyre për të qenë pjesë aktive e diskutimeve që kanë të bëjnë me strategjinë e Unionit të Bizneseve. Një numër i konsiderueshëm pjesëmarrësish, konfirmuan edhe antarësimin në UB. Erfolg verbindet!

Unioni i Bizneseve shqiptare-gjermane
në Gjermani.





UNION BUSINESS
Albanisch & Deutsch



Me rastin e Ditës së Flamurit,
Unioni i Bizneseve shqiptaro-gjermane
në Gjermani uron të gjithë shqiptarët.

Gëzuar 28 Nëntori!

23 vjet ia ktheu shpinën të birit!

*Kurrë nuk do të di-
hej pse e kishte lënë
të birin në klinikën
e lindjes. Një fëmijë
i porsalindur do të
mbetej pa nënë dhe
ashtu, siç thonë, dielli
do të ndalej...*

Një djalë i vogël, e me sy të kaltër, do të mësohej t'i kishte shumë nëna në repartin e klinikës së lindjeve. Ai do të mësohej t'i donte kukullat dhe lodrat, duke i parë të gjitha zonjat si nënë të tij. Dy vjet qëndrim në repart dhe më pas në një shtëpi tjetër prej nga do ta bënte një nënë te re, së cilës Zoti nuk i kishte dhënë fëmijë as pas 23 vjet martese, ishte fati i Drilonit të vogël, i lënë në mëshirën e kohës. Por, tre vjet pasi e adaptuan Drilonin,

çiftit Zoti u fali djalë, duke i bërë dy djem pa dallim.

RRËFIMI QË MË PREKU NË SHPIRT...

Dhe, një ditë, teksa punoja në zyrën time, në derë hyjnë dy zonja.

"A mund të hyjmë se kemi nevojë për një bisedë?", tha njëra prej tyre.

Dhe, pasi ua bëra me kokë që të hyjnë brenda, ulen zonjat në karriget afër derës dhe më tregojnë se qëllimi i bisedës kishte të bëjë me një fëmijë, i cili, sipas tyre, po jetuaka në afërsi të shtëpisë sime dhe qenka rreth 23 vjeç.

Dhe, menjëherë më shkoi mendja te Driloni, djali i fqinjës sime, i cili e di se është i adaptuar dhe është përfatshëm i moshës që e thanë ato.

E, kur u thashë se e njoh, ajo, më e moshuara, u ngritë nga karrigia dhe m'u hodh në përqaftim.

Andaj, bisedë pas bisede, u tregova në

hollësi për të, sepse e njihja mirë, meqë ishte rritur në fqinjësi.

U ZBULUA E VËRTETA, EDHE PSE E DHEMBSHME...

Megjithatë, disa ditë më vonë, po të njëjtat, erdhën t'më falënderojnë që ua kisha hapur rrugën dhe më tregojnë se e ëma që e ka rritur Drilonin i kishte pritur mirë dhe u kishte thënë se ka qenë e vetëdijshme se një ditë do të zbulohet e vërteta, sado e dhembshme qoftë ajo.

"Djali e ka ditur me kohë se mua nuk më ka nënë të vërtetë", i kishte thënë ajo gruas që e kishte lindur Drilonin. Pastaj, e thërret Drilonin e i thotë me qetësi:

"Drilon, këto janë mysafiret më të mira që kemi pasur ndonjëherë. Kjo është nëna jote, e kjo tjetra tezja jote".

Djali stepet dhe dashur e pa dashur zhgërehet në vaj. E, bashkë me to edhe të tri gratë që ishin me të...

S.



Mandarine Restaurant by Marina Bay
+35533410000
+355696041000

Lime Lounge by Marina Bay
+355696041001
info@marinabay.al
www.marinabay.al

Adresa: Vlorë, Shqipëri



Politikanët tanë janë deri në fyt me gjynahe!

Politikanët tanë na vjedhin, por, për çudi, i votojmë! I gjykojmë, por i duam! Zhyten deri në fyt në gjynahe, e ne me votën tonë i nxjerrim, sepse nuk dinë not mirë!

BATUTA PËR HAJNIN

Ishte një familje me traditë intelektuale. I zoti i shtëpisë i kishte katër djem. Ai takohet me një shok të kohës pas tridhjetë vjetësh që nuk ishin parë dhe fillojnë muhabetin.

E pyet njëri-tjetrin:

"Sa djem i ke?"

"Katër", ia kthen.

"A kanë mbërri hiq a ende janë të rinj?"

"I madhi është jurist, i dyti profesor, i treti asistent në fakultet".

"Paj, intelektualë keni qenë dhe gjithmonë do të mbeteni. Po, i katërti?"

"Eh, i katërti nuk është intelektual!"

"E, çka është?"

"Është hajn."

"Au bre, ua paska prishur strukturën! Pse nuk po e largoni nga shtëpia?!", e këshilloi ai.

"Jo, si me humb djalin?! Mu ai po na mbanë! Po t'mos jetë ai s'ka kush na mbanë!". Pra, edhe te ne, ai që vjedh i ka të gjitha e i ndershmi punon sa për të siguruar kafshatën e gojës...

BATUTA PËR DASHNORET

Njëri i kishte dy dashnore. I mbante fshehurazi, por në fund e madhja e gjeti me tjetrën. Kur e pyeti pse e tradhtonte dhe nëse e donte më shumë atë, të dytën, ai iu përgjigj:

"Të kam thënë që jam ashik, prandaj ashiku nuk mund të thotë cilën e do më shumë, por unë u dua të dyjave njësoj". Dhe, një ditë u grindën aq shumë sa të dyja shkuan te ashiku për ta kuptuar të vërtetën.

E madhja i tha ashikut:

"Tash, që jemi këtu të dyja, tregona saktë cilën na do më shumë?"

"Njëjtë", i thotë ai.

Dhe, një ditë ashiku shkoi në çarshi. Teksa ndodhej në treg fishkëllente nga zori i të dashurave. Një tregtar i tha:

"Çka po fishkëllen, he burrë?!".

"Sikur t'ishe ti në vendin tim, do të fishkëlleje tri herë më shumë se unë!", ia ktheu ai.

"Pse?"

Dhe, i tregoi të vërtetën...

"Lehtë e paske, he burrë. Bliji dy gjerdanë të kaltër dhe secilës jepja fshehtë tjetrës. E, kur të pyesin cilën e do më shumë, thuaj asaj që ia kam dhënë gjerdanin e kaltër", e këshillon tregtari. Andaj, kur u kthye ashiku në shtëpi ia dha secilës nga një gjerdan të kaltër tinëz tjetrës. Por, në ditën tjetër, kur u takuan të dashurat ndërmjet veti, u kapën sërish për dashurinë e ashikut dhe erdhën te ai për t'u sqaruar. "Cilën na do më shumë?", e pyetën ashikun. "Atë që i kam dhënë gjerdanin e kaltër!", thotë ai. Dhe, duke parë e madhja se kishte një hile, i tha: "Lëri ti gjerdanët, por më thuaj se nëse ne të dyja biem në ujë të thellë, cilën do e shpëtoje më parë ?!". Ashiku i thotë: "Më duket se ti di pak not, kurse e vogla nuk di fare!".

BATUTA PËR DIVORCIN

Kur i dëgjon paritë politike duke folur për shtetin, njeriu bindet se këta janë shpëtimtarët e popullit. E kanë mirë çdo gjë që flasin, janë shpëtimtarët e shtetit! I kërkoi Nastradini gruas bukë dhe ajo i solli një copë të madhe. Kur i solli bukën i tha më sill djathë grua se djathi është më i miri, të rregullon barkun, të ngopë trupin fuqi!". Gruaja i tha: "Për Zotin nuk ka mbetur djathë!". "Mirë që nuk ka mbetur se djathi ta prish barkun, ta merr fuqinë!". "Çka po thua, o njeri?! Sa ashtu e sa kështu!", ia kthen gruaja. "Qysh është vendi grua ashtu duhet të bëhen fjalët", i thotë ai. Dhe, Nastradini e thërrasin ta gjykojë një divorc. Hyri gruaja që kërkonte divorc te Nastradini. Ai e mori në pyetje. "Pse po ndahesh nga burri?", e pyeti. "Nuk po jetohej më me atë burrë! Shan në shtëpi, nuk i edukon fëmijët, bërtet dhe bën zullum në mua, prandaj a s'është më mirë të ndahem?!", ia kthen ajo. "Mirë e ke!", i thotë Nastradini. E, kur i vjen radha burrit të tregojë pse po ndahet nga gruaja, ai i thotë: "Nuk jetohej më me këtë grua! Nuk punon, është gjumashe... A nuk është më mirë të ndahem?". "Mirë e ke!", i thotë Nastradini. E, femra që mbante procesverbalin i thotë: "Nastradin, çka u mor vesh puna jote: gruas i the mirë e ke, burrit mirë e ke?". "Edhe ti e ke mirë?", ia kthen Nastradini. Pra, edhe te ne, në Kosovë, kah i dëgjon politikanët tanë si flasin, njeriu krijon përshtypjen se të gjithë e kanë mirë...

Sokol Murturi

Nuk e mbulon pluhuri i harresës



E papërsëritshmja

Ditë më parë ishte 87-vjetori i lindjes së aktorese papërsëritshme, Melihate Ajeti, e cila u lind në Prishtinë, më 9 tetor 1935. Aktrimin e kreu në Prishtinë. Bëri specializim në Paris (Comedie Française).

Aktorja numër një e teatrit prishtinas, e nisi aktrimin në moshën 16-vjeçare, më 1951, në Teatrin Krahinor të Kosovës dhe shkriu në skenë 180 role kryesore me të cilat dëshmoi talentin, bukurinë e kapacitetin e madh prej aktore.

Melihate Ajeti që një kombinim mes të prekshmes dhe mitologjikes, mes përalllores dhe të dukshmes. Rolet e saj në teatër, si "Erveheja", "Vajza pa pajë", "Kur pranvera vonohet", "Trim", "Etja", e bëjnë Melihate Ajetin primadonë të filmit e të Teatrit Kombëtar të Kosovës.

Shpërblimet e lëvdatat e panumërta për "Ervehenë", "Zonjën me Kamelie", "Hajri-jen", e shumë të tjera, nuk i zbehë koha dhe as nuk i mbulon pluhuri i harresës. Vdiq më 2005, në Prishtinë.

Eventet familjar e shoqërore me ushqime deti, vetëm “N’Peshk Terrace” në Veternik

Vitet e fundit ushqimet e detit janë shumë më të pranishme edhe në vendin tonë, ndërkohë ato më të mirat, më të fresktat dhe me shijen e cilësinë më unike, provohen vetëm në “N’Peshk Terrace” që gjendet në Veternik në Prishtinë.

Restauranti është i njohur për produktet më të freskëta të ushqimit të detit në Kosovë.

Gatimet dhe servirja janë aq mbreslënëse, sa që të kthehen në fiksion dhe kjo është arsyeja që restorantit ka një klientelë të madhe që e viziton.

“N’Peshk Terrace” ofrohen lloje të ndryshme dhe speciale të pjatave, nga ato që mund ti gjeni vetëm aty dhe në asnjë vend tjetër. Jo më kot është në krye të listës A të restoranteve më të mira në vend.

Ndërkohë, aty gjeni një ambient fantastik dhe tejet të përshtatshëm për organizimin e eventeve të ndryshme, si ditëlindje, fejesa, darka e dreka familjare.

A ka më bukur sesa një event me ushqime të freskëta deti në një ambient që i ofron të gjitha, duke nisur nga pamja, komoditeti, privatësia dhe shërbimi ekselent.

Siç tashmë dihet, “N’Peshk Terrace” gjithmonë përzgjidhet nga personat me influencë në vendin tonë, duke filluar nga estrada, biznesmen, politikan, etj.



BOOM

*Në botën e
Luan Krasniqit...*

*Artiola Toska
flet për
operacionet
plastike*

*Mozzik
në kërkim
të femrës
ideale*

Psikologe
Aljona
Aliajdaraj-
Jonuzi

*dhe bashkëshorti i saj
e kanë bërë që moti
“Bashkimin Kombëtar”!*

*Të famshmet
që luftuan
me depresionin*

Psikologe Aljona Aliajdaraj-Jonuzi dhe bashkëshorti i saj e kanë bërë që moti “Bashkimin Kombëtar”!

Aljona Aliajdaraj-Jonuzi është ndër emrat më të njohur të fushës së psikologjisë në Shqipëri e Kosovë. Përkushtimi i saj për t’u ndihmuar njerëzve në mënyrë profesionale është i jashtëzakonshëm dhe nuk kufizohet vetëm brenda mureve të zyrës së saj në Tiranë. Është nga Kosova, e shkolluar në Universitetin PFUR në Moskë, ku ka marrë edhe gradën doktor, ofron edhe seanca individuale në zyrën e saj në Tiranë, seanca me video-call dhe, po ashtu, ka një rrjet të tërë ndjekësish në “Instagram”, të cilëve u vjen në ndihmë me përgjigje adekuata në pyetjet që i bëhen përditë.

Ndonëse nga Kosova, Aljona Aliajdaraj-Jonuzi jeton dhe vepron në Tiranë falë dashurisë. Është e martuar në Shqipëri dhe bashkë me të shoqin me kohë e kanë bërë “bashkimin kombëtar”.

Për të, profesionin dhe jetën private, flasim në “Boom”...



Aljona Jonuzi tashmë emër i njohur. A keni pritur që një ditë do të jeni kaq e kërkuar si profesioniste?

- Kur erdha fillimisht në Shqipëri, njerëzit kishin një reagim disi të zbehtë kur zbulonin profesionin tim dhe më së shumti shpreheshin: “Eh, psikologjia në Shqipëri nuk është aq e kërkuar”. Ndihesha keq, pasi bëja krahasime me vendet ku kam jetuar, ku të shkosh te psikologu është gjëja më normale dhe më e mirë që mund të bësh për veten. Ndaj, i vura vetes një qëllim: Të thyej tabunë e psikologut në vendet ballkanike.

Andaj, kam punuar dhe investuar shumë në aspektin profesional për të arritur qëllimin e sensibilizimit.

Cila është formula e suksesit?

- Punë, punë dhe vetëm punë! Nëse puna bëhet me pasion, do të arrini shumë larg. Sigurisht, edhe investimi në trajnime dhe në teknikat më të reja në fushën profesionale. Nëse njeriu nuk ndalet së mësuari, përmirëson veten çdo ditë dhe procesi të përbushë dhe të jep vetësiguri.

Të jesh psikologe do të thotë të dëgjosh histori, probleme, ngërçe emocionale. A është kjo ngarkesë për ty apo i merr këto si gjëra profesionale?

- Në fillimet e mia e kam praktikuar profesionin në një klinikë të madhe rehabilitimi në Rusi, ku ishte një ngarkesë e madhe. Gjatë muajit të parë të punës i përjetoja problemet bashkë

me klientët, madje edhe problemet e tyre fizike.

Më pas, pas disa mbikëqyrjeve nga mjekë me përvojë dhe mësimi i teknikave të ndryshme, mësohesha të bësh një “mur” mes klientit dhe vetes. Kjo nuk do të thotë se nuk përfshihem në problemet e tyre, por i shoh më thjeshtë dhe nuk i përcjell problemet e tyre në shtëpi.

A vazhdon të ketë ende tabu-vizita dhe konsulta te psikologu?

- Krahasuar me 9 vjet më parë, kur edhe erdha në Shqipëri, ka ndryshime të mëdha. Kur dikush e sugjeronte dikë të shkonte të vizitohej te psikologu, qoftë edhe të fliste me të, e damkosnin “ky/kjo s’është mirë nga trutë”. Por, me kohë njerëzit janë ndërgjegjësuar dhe po kujdesen më shumë për shëndetin mendor.

Fushatat e ndryshme në rrjete sociale, mesazhet inkurajuese nga shumë blogere apo psikologe, na e kanë lehtësuar disi kontaktin.

Andaj, askush nuk duhet të ketë turp të kujdeset për mendjen...

Përgjithësisht, është vështirë të flasësh për gjëra shumë personale, por te ju klienti duhet të rrëfëhet. A paraqet kjo sfidë për ta?

- Meqë mua më shumë më njohin nga rrjetet sociale, s’e kanë shumë problem t’më kontaktojnë apo edhe të flasin. Por, edhe në rastet kur ndodh një bllokim, me një bisedë të lirshme, arrijmë

të zbërthejmë gjithçka, madje edhe traumat e harruara nga vetë ata. Komunikimi në rrjete sociale, njohja paraprakisht me figurën time si psikologe, këshillat e dhëna, shkrimet apo postimet për tematika të ndryshme na kanë afruar më shumë. Shumë ndjekës më shkruajnë edhe qoftë për një fjalë të ngrohtë, për një këshillë më shumë dhe për t'i orientuar se ku duhet të drejtohen.

Cili është termi profesional që psikologu e përdor më së shpeshti, me raste edhe “abuzon” me të?

- Gjëja e parë që më erdhi në mendje është fjala “ankth”. Ka shumë pyetje për ankthin, ka shtim të madh të numrit të personave që po e përjetojnë, sikundër po vjen duke u shtuar edhe ndërgjegjësimi. Tani flasin të gjithë lirisht për të. Madje, kur një herë po bëja një seancë “online”, më dëgjoi djali që u fut pa e ditur se unë isha në studion time dhe më pyeti: “O mamë, pse vetëm për ankthin flet? Ç’është ankthi?”. Normalisht, ia shpjegova dhe u mundova t’më kuptoj, edhe pse është fëmijë.

Cilat probleme i trajtoni më së shpeshti?

- Siç përmenda edhe më sipër, kërkesa më e madhe vjen nga persona që vuajnë nga çrregullimet e ankthit, mungesa e vetëbesimit, problemet familjare, traumat e ndryshme dhe tematika psikologjike.

A ka informacion të mjaftueshëm në Shqipëri për shëndetin mendor?

- Viteve të fundit ka shumë më shumë, krahasuar me kohën para disa vjetësh. U jap këshillë lexuesve se informacionet duhet t'i marrin nga profesionistët e fushës se çfarë nuk lexojmë në ditët e sotme në internet...

Jeni aktive në rrjete sociale, që do të thotë se jeni koherente. Sa e kanë afirmuar rrjetet sociale punën tuaj si psikologe?

- Gjatë periudhës së tmerrshme të tërmteve në Shqipëri, unë u aktivizova thuatse çdo natë duke bërë “live” në faqen time me ushtrime mbi ankthin dhe qetësimin, gjatë asaj periudhe të trazuar.

Më pas pasoi karantina dhe njerëzit u përballën me probleme të mëdha të shëndetit mendor, që as nuk i kishin kuptuar që i

kishin.

Ofroja këshillat e mia falas në faqen time, i dëgjoja dhe me ushtrimet “online” përpiqesha t'i ndihmoja.

Dhe, kështu, numri sa vinte e shtoej. Më shkruanin mesazhe pa ndalur...

Kemi vënë re se ua kthen përgjigjen të gjitha pyetjeve që të adresohen. A e keni vështirë?

- Përpiqem të jem sa më aktive kur kam hapësirat e mia të lira apo në mes të orareve të seancave. Nuk dua të lë askënd pa përgjigje apo këshillë se ku duhet të drejtohen. Kjo gjë më bën të ndihem mirë, ndaj nuk i lë pas dore.

Ndjekësit shpesh shprehin admirimin e tyre ndaj teje, si ndihesh?

- Pa diskutim, fjalët e mira më shtyjnë të ecë përpara. Lumturia ime më e madhe, apo njësia matëse e suksesit tim, është mirëqenia e tyre.

Po, jeta juaj private?

- Pjesë e familjes sime janë bashkëshorti dhe djali. Të mos harrojmë edhe mamin dhe familjen e vëllait, që jetojnë në Kosovë. Ata janë bota ime, e mbushur me dashuri të madhe...

Ju prej kohësh e keni bërë “bashkimin kombëtar”, meqë je nga Kosova e bashkëshorti juaj nga Shqipëria. Hë?

- Po-po, 15 vjet më parë...

Si jeni njohur?

- Jemi njohur në Moskë. Kemi qenë të dy në studime atje, ai në mjekësi e unë në psikologji. Rastësisht u njohëm në një nga kafenetë e studentëve në universitetin tonë.

Unë isha e vetmja nga Kosova dhe më njihnin pak a shumë të gjithë studentët e Shqipërisë. Dhe, aty u bëmë bashkë...

Cili është sekret i martesës së lumtur, edhe kur partnerët janë nga vende të ndryshme?

- Nuk ka asgjë më të mirë sesa komunikimi, mirëkuptimi dhe toleranca.

Për fund, një përgjigje pa pyetje?

- Të gjithë lexuesve të Revistës suaj u uroj ta duan sa më shumë veten, të investojnë sa më shumë në vetveten, të besojnë se ky ai çelësi i suksesit në çdo fushë profesionale, por edhe personale!

Nderim Neziri





ADRIANA MATOSHI: JAM E LUMTUR!


“Në jetën reale jam shumë pozitive, e dashur dhe e singertë. Kam shoqëri dhe falë karakterit që kam, më duan shumë dhe jam shumë e lumtur me gjithçka që më rrethon”.

NASER RAFUNA: DIHET KUSH KA ARDHUR NGA QIELLI...

“Lexoj shumë libra dhe e kam tejkaluar numrin katër shifror të lexuarit të tyre. Ndërsa, libri që më lë përshtypje më shumë është, pa dyshim, Kurani.

Por, para se ta lexoja Kuranin kam lexuar mjaft BestSellera të autorëve të mëdhenj botërorë.

Por, dihet çka ka ardhur nga qielli e çka nga imagjinata dhe inspirimi, duke pasur autori vetëm perceptimin, imagjinatën dhe motivin”.



TEUTA KRASNIQI: NUK DUHET DORËZUAR!

“Kam mësuar se me punë arrihet gjithçka dhe pa marrë parasysh vështirësitë që do të hasësh në profesion, asnjëherë nuk duhet dorëzuar”.



A family consisting of a man, a woman, and two young girls are walking together on a paved path. The man is on the left, wearing a green sweater and tan pants, holding the hand of the first girl. The woman is on the right, wearing a light-colored jacket and jeans, holding the hand of the second girl. The two girls are in the middle, wearing pink and red sweaters. They are all smiling and looking towards each other. In the background is a modern, multi-story apartment building with a dark facade and large windows. The scene is set in autumn, with trees having orange and yellow leaves.

Kompleksi Ulpiana Center – Lipjan



**Kompleksi
Dardania – Prizren**

A large, three-dimensional white '10%' is the central focus of the lower half of the image. It is placed on a grassy field with scattered autumn leaves. In the background, there are modern apartment buildings under a sunset sky. The overall scene is peaceful and inviting, suggesting a high-quality living environment.

10%

ZBRITJE



Të famshmet që luftuan me depresionin

Janë të talentuara, tërheqëse, të pasura dhe të njohura ndërkombëtarisht... por nuk i shpëtuan përbindëshit të depresionit. Por, as fama dhe as pasuria nuk mund t'i "vaksinojnë" të famshmit kundër depresionit shkatërrues. Përveç të famshmëve, e që, fatkeqësisht, e dimë se i kanë dhënë fund jetës shkaku i depresionit të rëndë, ka disa të tjerë që kanë treguar se e kanë luftuar dhe e kanë kapërcyer ose vazhdojnë ta luftojnë. Ne grumbulluam disa vajza të famshme që janë përballur me depresionin në jetën e tyre dhe nuk kishin turp të flisnin publikisht për të.



KIRSTEN DUNST

Aktorja 39-vjeçare tregoi se kur ishte në të 20-at, hyri në rehabilitim për të ndihmuar me depresionin.

Dunst thotë se ajo luftoi me këtë gjendje për vite dhe kuptoi se po krijonte shumë zemërim. "Gjithçka që do të them është se mjekimi është një gjë e shkëlqyer dhe mund t'ju ndihmojë, vërtet, të largoheni nga diçka," thotë ajo.



KATY PERRY

Ylli i popit ndau luftën e saj me depresionin gjatë një transmetimi të drejtpërdrejtë në "YouTube" 96-orësh. Në një takim emocional me Siri Sat Nam Singh, mikpritëse e Viceland's Therapist, Perry tha se ajo u hap, sepse donte që fansat e saj ta shihnin atë të vërtetë.



LADY GAGA

Ylli i popit, hitet e së cilës përfshijnë "Paparazzi" dhe "Poker Face", thotë se ka luftuar me depresionin dhe ankthin gjatë gjithë jetës së saj.

Gaga nuk ka turp të pranojë se merr ilaçe për depresionin. Në një intervistë tha se beson se është e rëndësishme që njerëzit të flasin për shëndetin e tyre mendor.



KRISTEN BELL

Aktorja e njohur thotë se ka qenë në depresion qëkur ishte në kolegji. Bell thotë: “Nuk ka asgjë të dobët në luftën me sëmundjet mendore”. Ajo doli publikisht në përpjekje për të hedhur më shumë dritë mbi çrregullimin dhe për të lehtësuar figurën e krijuar rreth tij.



GWYNETH PALTROW

Aktorja fituese e çmimit “Oscar” hodhi dritë mbi depresionin pas lindjes kur foli për betejën e saj 5 muajsh pas lindjes së fëmijës së saj të dytë, Moses.

“U ndjeva si një zombie. Nuk mund të hyja në zemrën time. Nuk arrija të qasja në emocionet e mia. Nuk mund të lidhesha”, thotë ajo.

Ajo përjetoi depresion klinik pas vdekjes së babait të saj më 2002.



CARA DELEVINGNE

Në moshën 15-vjeçare Delevingne ishte e pasur dhe e famshme, por u godit nga një “valë e madhe depresioni, ankthi dhe urrejtje ndaj vetvetes”.

Një përpjekje fillestare për terapi dhe mjekim nuk ishin të dobishme, andaj Delevingne u kthye në sjellje të dëmshme.

Artiola Toska

flet për operacionet plastike

Ka zë të mrekullueshëm dhe ëmbëlsi të pakrahasueshme. Jo më kot mbetet e dashur prej shumë e shumë vitesh. Artiola Toska, zëri i bukur i muzikës popullore, së fundi ka ardhur më moderne me këngën “Mirëmëngjes dashni”, në bashkëpunim me Brunon. Kënga është shndërruar në hit.

Dhe, ndonëse vitet ecin, Artiola mbetet gjithherë e freskët. Ndoshta është nga të paktat artiste që nuk ka bërë ndërhyrje të kirurgjisë plastike.

Këngëtarja ka folur në lidhje me këtë temë aktuale viteve të fundit: “Sa i përket operacioneve plastike, apo ndërhyrjeve të lehta, sot në Shqipëri po aplikohen shumë. Nuk jam dakord, sidomos, me ato femra që i bëjnë të tilla gjëra në moshë fare të re, ndërkohë që kanë vetë freskinë e moshës.

Megjithatë, gjithçka varet nga dëshira e secilit, por unë vetë nuk do ta bëja kurrë një gjë të tillë”.



Mozzik në kërkim

të femrës ideale



Tashmë të gjithë e dinë emrin e tij, pasi është njëri ndër reperët më me influencë në muzikën shqiptare. Mozzik u bë shumë i njohur dhe i ndjekur nga publiku, sidomos nga të rinjtë. Ndonëse është i famshëm, edhe ai ka raste kur ndjehet vetëm.

“Vjen ajo ndjen, edhe pse kur mendohesh mirë, del që ke shumë persona rreth vetes që të çmojnë”, thotë Mozzik. E, sa i përket jetës private, reperi thotë se është vetëm dhe se ende nuk e ka takuar femrën ideale.

Plexr! Shkopi magjik i Hirushes!

I njohur ndryshe si “Zhdukësi i Rrudhave” Plexr zhduk jo vetëm rrudhat por çdo shenjë mbi lëkurë.

Plexr është një alternativë trajtimi jo-kirurgjikale për të eliminimin e rrudhave dhe për lifting të lëkurës. Trajtimi kryhet me pika të krijuara nga pajisja Plexr për të sublimuar (ndryshuar nga të ngurta në gaz) qelizat sipërfaqësore të lëkurës pa gjakderdhje apo dëmtim të indeve përreth. Plexr është një trajtim efektiv për individët me lëkurë të tepërt në qepallat e sipërme dhe të poshtme, linja të imëta dhe lëkurë të dëmtuar. Ky trajtim mund të kryhet për çdo lloj lëkure. Kjo procedurë nuk përfshin prerjen e lëkurës ose qepjet që do të thotë ka një kohë shërimi më të shpejtë. Është një opsion i shkëlqyer për individët që nuk janë gati për kirurgji të qepallave ose për ata që nuk janë të përshtatshëm për një blefaroplastikë kirurgjikale. Është e vetmja aparaturë që bën të mundur eliminimin e ksantelazmave për të cilat kirurgjia akoma nuk ka gjetur zgjidhje.

Plexr përdoret gjithashtu për eliminimin e:

- lëkurës së lëshuar në sy (Bleferoplastika)
- shenjat kirurgjikale
- shenjat post akne
- nishanet
- njollat e diellit dhe të moshës
- strijat
- tatuazhet etj.



Pacientja ka përfituar rigjenerim tërësor të lëkurës jo vetëm duke eliminuar rrudhat por dhe duke aktivizuar prodhimin e qelizave të reja.

Na kontaktoni:

Tel: 069 211 1919 | Email: allure.beauty.tr@gmail.com | Instagram: [allurebeauty](https://www.instagram.com/allurebeauty)

Adresa: Rruga “Reshit Collaku”, Tiranë

Me Dilen kam kaluar më shumë se dy muaj. Ndoshta do të ishim bashkë për një kohë më të gjatë, pse jo edhe tërë jetën, sikur të mos ndodhte ajo që kurrë nuk e kisha pritur prej saj. Më kishte gënjyer kur kishte qenë e detyruar të flinte me një pronar të një firme për të mos e dëbuar nga puna e mirë që gëzonte...

Ndërkaq, e kaluara e Mimosës, të cilën tash e sa vjet e kam edhe grua, edhe pse i pata thënë se nuk më pengon nëse femra nuk është e virgjër, megjithatë, nuk po më lë rehat, po ma bren shpirtin!



Gruaja ime para meje i ka pasur 5 dashnorë!

Dilen nuk kam mundur ta paramendoj ndryshe, veç si një prostitutë që mund t'ua hapë këmbët në çdo kohë kujtdo qoftë. Për këtë arsye i kam thënë se nuk dëshiroj të vazhdoj më me të dhe që nga ajo ditë e kam parë përdore me mashkull tjetër.

Kushedi edhe sa dashnorë të tjerë do t'i ketë ajo deri në ditën kur ndonjërin prej tyre do ta verbojë bukuria dhe dinakëria e saj, sepse, vërtet, Dila ishte shumë e bukur, por edhe tepër dinake.

Kurrë nuk i kisha simpatizuar femrat që kishin qenë shumë të bukura...

Dhe, për këtë shkak ende nuk kisha rënë në dashuri me asnjë femër, e cila, në radhë të parë, ka qenë edhe simpatike, por edhe e sinqertë dhe zemërbujare.

Nganjëherë më duhej të pranoja një fakt se është vështirë për një mashkull të martohet dhe të krijojë familje me një femër e cila para tij ka fjetur me kushedi sa meshkuj të tjerë. Kjo për shkakun se gjithë jetën do t'i rrijë në mendje e kaluara e gruas së tij dhe vazhdimisht do të dyshojë se ajo do i ripërtërijë lidhjet tinzare me ata edhe gjatë kohës martesore.

Më brente vetëm një gjë: Pse vajzat nuk flisnin me singëritet të plotë për të kaluarën e tyre?
Mua më ka ndodhur që me shumicën e femrave, me të cilat kam dalë, jam njohur dhe jam dashuruar, që të gjitha t'më thonë se e kanë pasur vetëm një frajer. Por, te unë nuk prishte punë nëse vajza e cila më pëlqente jashtëzakonisht dhe, kuptohet, që më përshtatej të ketë pasur një apo dy të dashur, me të cilët nuk u ka ecur. Shkurt dhe shqip: nuk më interesonte çfarë të shkuare ka pasur e dashura ime, vetëm më interesonte të di se ajo nuk ka qenë prostitutë dhe s'ka punuar në ndonjë shtëpi publike. Tjetër gjë është nëse ajo ka qenë e dashuruar në një person dhe ai e ka tradhtuar, e ka lënë... Vetëm dëshiroja t'më siguronte një femër se nesërpasnesër, kur ajo të bëhej gruaja ime, të mos e shikojnë në rrugë si ndonjë nga ato vajzat që s'kanë lënë kujt pa ua plotësuar dëshirat seksuale. Për këtë arsye ndodhesha në dilemë të madhe për të vendosur se kur duhet të martohem dhe me kë... E pranoj se kam pasur femra të bukura, ndonjëra prej tyre edhe sot e kësaj dite më simpatizon, por asnjëherë nuk më ka ndodhur që dikush nga të dashurat e mia t'ma thotë realitetin e jetës së tyre.

ISHA NGOPUR ME AVENTURA, DOJA TË MARTOHESHA...

Kam ardhur në një përfundim shumë real se femrat gjithnjë trillojnë diçka, shpikën dhe mundohen të të shtinë në gjynah. Nuk mund t'i duroja kur thoshin se gabimisht janë dashuruar dhe kanë kuptuar më vonë se i dashuri i tyre ka qenë i martuar ose ka përdorur drogë.

Por, unë kam pasur një rregull të cilin gjithnjë e kam përdorur: kurrë nuk i pyesja femrat i sati dashnor i tyre isha, sepse e dija mirë se asnjëra prej tyre nuk e thotë të vërtetën.

Mund të ketë vajza që, vërtet, kanë pasur vetëm një dashnor, por shumica e të tjerave, kur kanë "gabuar" një herë, kanë provuar dashurinë edhe herëve të tjera dhe kështu përsëri kanë "gabuar" dhe janë mashtruar.

Si i ri vetja më dukej se jam njëfarë mashkulli, por ç'është më e rëndësishmja femër që dua nuk kisha. 30 vjet i kalova pa u martuar. E ndieja mungesën e dikujt, së cilës do i përkushtohesha me gjithë fuqinë e jetës sime. Është e natyrshme se për femra kurrë s'kam hequr asnjëherë, por ç'është e rëndësishmja nuk gjeja mënyrë sesi të vija deri te kontakti me ndonjë vajzë që bënte për mua.

Çuditërisht, kisha njohur natyrën e shumë femrave, të cilat normalisht që dëshironin të njiheshin me mua, por më pas, në takimet tjerë, ato ose nuk dilnin fare në orarin e caktuar ose më shkruan sms se s'kishin gjetur te unë "as fijen më të vogël të seriozitetit". Unë, kuptohet, nuk mërzhitesha nga kjo, sepse nuk planifikoja ndonjë aventura me to. Isha ngopur me aventura. Më dukej se nuk e kisha më atë kohën e dikurshme për të dashuruar... as atë vrullin rinor për të pasur në të njëjtën kohë nga dy e tri dashnore. Me secilën femër që doja të njihesha me të, menjëherë dëshironte të martohesha me mua ose i interesonte nëse kemi mundësi të iknim diku jashtë shtetit.

Dhe, vetë fakti se ato donin aq shpejt të martoheshin me mua dhe të iknim jashtë, tregonte se e kaluara e tyre nuk ishte edhe aq e mirë.

Unë, singërisht, isha i interesuar të gjeja një vajzë të bukur për martesë, por disa vajza me të cilat jam njohur pas daljeve tona të shpeshta nuk u pritej dhe më thoshin shkurt: "Unë dua që sa më shpejt të fejohe mi dhe martohemi, pa e zgjatur shumë muhabetin!".

VEÇ I KATËRTI A I PESTI S'KISHA DËSHIRË TË ISHA!

Isha kategorikisht i vendosur se përpara se të lidhesha përnjëmend me një femër, ta njihja mirë, pavarësisht nëse kishte pasur më parë të dashur, që e kishte shfrytëzuar për një kohë dhe, pastaj, ia kishte kthyer shpinën. Por, në asnjë mënyrë nuk mund të martohesha me një vajzë, e cila te unë sheh dashnorin e saj të katërt a të pestë.

"Nëse kërkon vajzë që ka pasur vetëm

një frajer ose të tregon drejt se sa i ka pasur, do të mbetesh pa u martuar! Ku po jeton ti?", më pat thënë njëra nga to, e cila i kishte shkelur të 25-at dhe e cila nuk e dinte as vetë se sa meshkuj i kishte pasur.

KISHA FRIKË SE KUR TË MARTOHEDO BËJNË ME GISHT KAH GRUAJA IME!

Po e përsëris edhe një herë se nuk më pengonte virgjëria e femrës, por më pengonte shumë nëse drejt saj bëjnë me gisht, duke e shikuar si prostitutë.

Kjo kishte dallim të madh dhe ishte esenciale për mua. Me shumicën e femrave që dilja për t'u njohur (disa nga to edhe i kam çuar në shtrat me insistimin tim apo me vetëdëshirën e tyre), pothuajse si njëra ashtu edhe tjetra më pyetnin shkurt e shqip që në ditën e parë të njohjes: "A të pengon ty virgjëria e femrës, o djalë?". Përgjigja ime ishte e sinqertë: "Jo". Mirëpo, ajo "jo" kishte edhe një domethënie tjetër, sepse, edhe pse tash jam i martuar dhe i kam dy fëmijë, nuk më hiqet dot nga mendja se gruaja ime nuk ishte e virgjër, ani pse kur më pyeti se a të pengon që nuk jam e virgjër, aso kohe i pata thënë me plot gojën: "Jo".

Konkretisht, isha më pranë se kurrë të martesës me Mimozen, e cila kuptohet se nuk ishte e virgjër kur u takua me mua. Ishte vetëm 20 vjeçe, por dukej më e vjetër, e bukur dhe inteligjente. Me fjalë të tjera, femër ideale për mua.

Për të parën herë po i besoja një femre se kishte qenë e dashuruar në një mashkull, i cili kishte ikur jashtë sa mbyllë e hapë sytë. I besova, sepse më dukej se ishte femër që nuk dinte "dallavere" dhe kështu dëshiroja që menjëherë të martohesha me të, të mos e zgjatja me fejesë dhe gjëra të tjera.

Dhe, ndodhi si ndodhi, u martuam dhe tash i kemi dy fëmijë si drita...

Por, sidoqoftë, edhe pse vetë dikur i kisha thënë se s'më pengonte virgjëria e femrës, tash, si më çekan, më rri në mendje e kaluara e saj dhe nuk më lë rehat...

Burim Bajrami



Pema që mbolli Naim Frashëri
para 145 vjetësh në Sarandë

Ku ndodhet pema 145 vjet që e mbolli Naim Frashëri?

Një pemë e madhe e piperit, e ardhur si fidan nga Maroku, është mbjellë në qendër të Sarandës nga dora e shkrimtarit Naim Frashëri, 145 vjet më parë.

Banorët thonë, si në formë gojëdhëne, por ky është fakt, tregon Jashar Bello, përgjegjës i Gjelbërimit në Bashkinë e Tiranës.

Bello tha se pema është e vjetër 145 vjet dhe është mbjellë nga Naim Frashëri në kohën kur punonte doganier në Sarandë.

Dhe, pavarësisht vjetërsisë, pema është në gjendje të mirë, por kjo nuk është meritë e institucioneve vendore në Sarandë, të cilat janë "kursyer" në shërbimet që i kanë bërë, pavarësisht vlerës dhe rëndësisë së veçantë që ajo mbart. "Disa krasitje, spërkatje, i janë bërë për ta mbajtur të gjallë, e që të mos ketë fatin e "simotrës" së saj, e cila u pre në vitet 90", u shpreh Bello.


"Pemën dekorative, që e shihni në fotografi, e ka mbjellë Naimi, në kohën kur ka punuar në doganën e Sarandës, 145

vjet më parë.

Dhe, përveç kësaj peme, Naimi ka mbjellë edhe të ashtuquajturën buganvile (Lulja e Sarandës), thotë Bello. Por, në Sarandë pak e dinë këtë histori. Disa nuk e kanë dëgjuar asnjëherë. Por, gazetari Limos Didani e gjeti pemën e vjetër të piperit. Ishte në qendër të qytetit bregdetar, në një vend të braktisur, e, ndoshta, më të lënin pasdore se kudo!

Dhe, për të shkuar deri te kjo pemë mund të orientohesh vetëm nga banorët e zonës, meqë nuk ka tabelë që e identifikon apo që rrëfen historinë e saj të mbjellë nga poeti i madh i Rilindjes Kombëtare.

E, sipas shkencëtarit të bujqësisë, Ahmet Osja, druri i piperit, që e ka mbjellë Naim Frashëri, kishte ardhur në formë fidani nga Maroku.



Rruga Pjetër Bogdani 3, Tiranë
tel. +355 69 666 6234
www.colonialtirana.com

 /colonial_tirana



Çka pritet nga brezi që rri zgjuar natën e fle ditën?


Rrahja e të moshuarës në Pejë, që ndodhi ditë më parë dhe tronditi opinion, është çështje për gjyqin. U bë mirë që rasti u zbulua dhe po hulumtohet e kaluara në shtëpinë e pleqve ku ndodhi ngjarja.

Por, në Kosovë nuk është vetëm kjo shtëpi e pleqve. Ka edhe shtëpi të tjera ku mund të ndodhin, e ndoshta edhe ndodhin gjëra të tilla... Dhunë ka edhe nëpër shtëpi private kudo në Kosovë. Lexojmë po thuajse çdo ditë se djali rrahu babën, nënën, burri rrahu gruan, por edhe gruaja rrahu burrin... Pra, të gjitha këto po ndodhin pothuajse çdo ditë në shoqërinë tonë kosovare... E, pse po ndodh kjo? Paga e përcakton jetën e njerëzve. Kështu, nëse punëtorët jetojnë në varfëri, ata ballafaqohen me sfida jetësore të sigurimit të bukës e veshjes së familjes. Konkretisht, nëse arsimtari ka probleme varfërie, ai nuk është në gjendje t'i pajisë sa duhet me dituri nxënësit. E, si ishte dikur? Neve, nxënësve, në oborrin e shkollës mësuesi na kontrollonte në xhepa se

çka mbanim në ta. Qëllimi ishte të mos mbanim duhan. I përshëndetnim mësuesit në rrugë, në oborr të shkollës a gjetiu me qëndrim gatitu dhe me duar asnjëherë në xhepa... Kur hynte në klasë mësuesi, por edhe arsimtari, kërkonte t'i vendosnim duart mbi bankë për të parë nëse i kishim të pastra, a i kishim thonjtë të prerë etj. Sidoqoftë, i vjetri respektohej, nderohej... Nuk kishte ndodhur ndonjëherë djali t'ia kthente fjalën babës. Nuk ndodhte ta rrihte kush plakun a plakën. Pra, çka po prodhon tash shteti i Kosovës për të ardhmen? Kosova është mbushur drogë e narkomanë. Narkotikët kanë arritur edhe në shkollat fillore e të mesme, në fshatra e qytete... E keqja e shtetit tonë është se "qajné" vetëm kur ndodh diçka e madhe, si, bje fjala, rasti i rrahjes së të moshuarës në

Pejë... Në anën tjetër, askënd nuk e sheh me libër në dorë, e me telefon po, madje kudo... Andaj, çka pritet nga brezi i ri që rri zgjuar tërë natën e fle tërë ditën? Xha Raifi, fqinji im, i thoshte të birit sa herë vonohej në mbrëmje se dita ishte për punë e nata për gjumë. Në anën tjetër, në Kosovë po krijohet edhe brezi i hajnisë, i kimit dhe i dhunës. Në fshatra vjedhin bagëti dhe kërcet pushka në mes të natës teksa hajnat ikin me lopë për dore... Po ashtu, kudo që shkon të kryesh punë duhet të japësh ryshfet... Andaj, shkurt e shqip, ka ardhur kohë e vështirë dhe s'di njeriu as çka të bëj, si të veproji... Shtrohet pyetja: Si të dilet nga gjithë ky kaos që na ka përfshirë?

Safet Krivaça





Burri im në çdo qytet e ka nga një dashnore!

E lexova mesazhin e burrit tim dhe, fatkeqësisht, zbulova se ai ka pasur disa afëra, e që ma ngritën tensionin...

Jam 55-vjeçare. Jam martuar me tim burrë para 30 vjetësh dhe asnjëherë nuk më ka shkuar mendja se burri im mban sekrete, të cilat e sollën martesën tonë në pikëpyetje.

Si ndodhi kjo?

E mora telefonin e burrit tim në një moment kur ai ndodhej në banjë duke u pastruar. Në çast, deri mundohesha ta gjeja kodin e hapjes, i erdhi një mesazh, i cili, për çudinë time, u hap vetë! Por,

fatkeqësisht, zbulova se ai qëmoti më tradhtonte...

DHE, MESAZH PAS MESAZHI...

Një ditë tjetër, teksa ai përgatitej për në punë, telefonin e kishte lënë mbi televizor. E, kureshtja se çka i shkruanin të dashurat më nxiti ta hapja sërish...

Një mesazh ishte ende i pahapur. "A do të takohemi sot pas pune?", shkruante. Dhe, nuk di as vetë se ku e gjeta kurajën dhe e thirra atë numër. Kur i tregova asaj gruajë se kush isha, ajo nuk e mohoi, por më tha se është nga Prizreni dhe me tim burrë është në lidhje dashurie që një vit. Asaj nuk i interesonte se unë isha e mërzi-tur, se bota ishte rrokullisur për mua...

DIGJE TELEFONIN PO TË DUASH!

Po atë ditë, në mbrëmje, kur im burrë u kthye nga puna, i thashë se në telefonin e tij e kam parë një mesazh të një femre nga Prizreni me të cilin ishte në lidhje. Për çudi, nuk u befasua, siç prisja. Uli kokën në shenjë pendimi dhe zë nga goja nuk nxori...

Dikur, pas një heshtjeje të gjatë, më tha: "I kam përfunduar të gjitha aferat! Digje telefonin po të duash".

Por, nga ajo ditë e deri më tash, zemra ime është e thyer se si ka mundur të ma bëjë këtë ai.

E dua, por nuk di a do të mund ta kaloj ndonjëherë këtë lëmsh që e kam në shpirt...

E. Thana



Spitali i specializuar për
Kirurgji Estetike dhe Plastike

MBJELLJA E FLOKËVE



A close-up photograph of a young couple in a romantic embrace. The woman, with dark hair and a small earring, is looking down with her eyes closed. The man is leaning in towards her, his face partially visible as he about to kiss her. They are both wearing white clothing. The background is softly blurred, suggesting an indoor setting with white linens.

A jam në rregull a jo?

Shkoj me burra të tjerë se ma lypë trupi!

Qe pesë vjet jam e martuar në Gjermani, por këtu ndihem e vetmuar...

Jam e lindur e rritur në Kosovë, por e martuar qe pesë vjet në Zvicër. Burri im është dhjetë vjet më i vjetër se unë.

U njohëm para disa vjetësh në Shëngjin, kur unë isha me familje e ai me dy shokë të tij. Ato ditë pushimi i kaluam bashkë dhe kur erdhëm në Prishtinë pas një jave u fejuam.

Por, martesë jonë u shty disa vjet shkaku se nuk kisha mundësi ta merrja vizën, të cilën mezi e mora para pesë vjetësh dhe ja therra te ai në Zvicër.

Në fillim çdo gjë ishte ideale, si në filma e romane dashurie, por pas dy vjetësh gjërat ndryshuan. Ai filloi të ftohej nga unë, edhe pse nuk ma thoshte një gjë të tillë.

Andaj, më lindi ideja që ta tradhtoja me shokun e tij më të ngushtë, i cili sa herë që e takoja në rrugë a shkallëve të soliterit tonë më përshëndeste me ëmbëlsi, më një qeshje të lehtë që ma dridhte trupin...

Dhe, një ditë, kur e dija se im burrë ishte saktësisht në punë, i shkova në banesë shokut të tij të ngushtë, i cili më priti krah hapur...

Por, nuk u ndala me kaq, sepse hakmarrja ime ndaj burrit që më injoron qe edhe më e madhe dhe nisa të kërkoj edhe meshkuj të tjerë...

Ndërkohë, u njoha me një të ri nga Presheva, i cili banon po në të njëjtin

soliter ku jemi edhe ne. Është i ri, rreth të tridhjetave, i pa martuar dhe plot energji për dashuri e seks. Me të ndihem si në ëndërr. Rimë bashkë sa herë që unë kam mundësi. Nuk ma kthen fjalën kurrë, por m'i shikon buzët kah flas e kah më dridhen sa herë që më puthë.

Mirëpo, as im burrë nuk është duke e lënë më keq se unë. Mbrëmjeve del nëpër diskoteka dhe nuk kthehet deri kah mesnata, edhe pse të nesërmen zgjohet herët dhe shkon në punë. Me siguri, ka edhe dashnore, por nuk e ka përmend kurrë një gjë të tillë.

E, pse unë po e bëj një gjë të tillë me të tjerë?

Sepse po ma lyp trupi, po kam nevojë për dashuri, për kënaqësi. E, burri nuk pa ma ofron një gjë të tillë...

Selvete V.



PARA

PAS



20 SEANCA

-13 KG

Qendrat e dobësimi 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimi gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht pritet që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksessit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimi tek këto qendra, me rezultate kaq

të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjavit, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimi.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epidermë), duke shpërbë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;
- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;
- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;
- Tonifikim i thellë;
- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;
- Përmirëson sistemin nervor;
- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;
- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;
- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;
- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;
- Lehtëson gjendjen e depresionit;
- Efekt analgjik;
- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

• Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;
- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;
- Humbje të peshës;
- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;
- Relaksim muskolor, etj.

• Pajisja e Dobësimi Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjavit.

• Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjamin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qullët trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.

Personaliteti juaj...

Më trego në cilin gisht e ke unazën, **të tregoj kush je!**

Të zgjedhësh në cilët gishta do të vendosësh unaza nuk është vetëm një stil i mërzitshëm, por kjo mund të tregojë më shumë për personalitetin tënd, mbase më tepër se çfarë keni ditur deri tani...



UNAZA NË GISHTIN E MADH

Në këtë udhëtim midis unazave dhe personalitetit nisemi nga gishti i madh, i cili për formën dhe madhësinë e tij është sigurisht një simbol i forcës dhe vetëbesimit. Zbukurimi do të thotë se dëshiron të tregosh fuqinë tënde.

UNAZA NË GISHTIN TREGUES

Një vendosmëri e caktuar mund të demonstron me gishtin tregues, gishtin që përdorim saktësisht për të treguar drejtimin ose për të sinjalizuar diçka. Nëse mban unazë në këtë gisht, mund të përcjellësh një karakter mjaft

kokëfortë dhe të shfaqesh si një person që e di se çfarë dëshiron.

UNAZA NË GISHTIN E MESIT

Nëse gishti tregues është gishti i vendosmërisë personale, gishti i mesëm na bën njerëz të përgjegjshëm. Edhe më shumë nëse vendos t'i japësh rëndësi me një ose më shumë unaza, gjë që do të tregonte edhe njëfarë ekuilibri.

UNAZA NË GISHTIN E UNAZËS

Gishti i unazës konsiderohet nga shumica si gishti i dashurisë. Në përgjithësi, zbukurimi i tij është një shfaqje e harmonisë dhe e dëshirës për të ndërtuar një familje.

UNAZA NË GISHTIN E VOGËL

Gishti i vogël është simbol i kotësisë, por edhe i një personi shumë krijues. Nëse je, vërtet, një zbukurues i trendëve, atëherë nuk mund të humbasësh të mbash gishtin më të vogël të një imitimi të bukur.

UNAZA NË DORËN E MAJTË

Të mbash unaza në dorën e majtë të bën një person të ndjeshëm me shumë imagjinatë, madje edhe artistike. Ndërsa nëse për gëzimet tuaja preferoni të drejtën, kjo do të thotë se jeni të fortë, me një personalitet dominues dhe shumë aktiv.



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

A ka qenë motra ime në lidhje me burrin tim?

Përsëndetje, jam një ish-kliente jotja që më ke ndihmuar para dhjetë vitesh që të marthohem me burrin që e kam sot. Më ke thënë se nuk është i rehatshëm dhe kjo ka dal shumë e saktë. Kam pasur probleme të vazhdueshme me burrë, sepse është vonuar shpesh në shtëpi dhe një pjesë të këtyre vonesave ia kam ditur pse kanë ndodhur, por nuk i kam bërë të mëdha... Ato i kam kaluar në heshtje, shpesh edhe duke u grindur me veten, por ia kam arritur të vij deri këtu me dy fëmijët e mi që i kam si drita. Nuk jam ndier e fyer deri në momentin kur zbulova se burri po fliste shpesh me motrën time në internet. Nuk di nëse ka pasur diçka mes tyre, por pse gjithë ato biseda? Gradualisht gjërat kanë shkuar deri aty sa mori vesh familja ime dhe u bënë gjërat e mëdha gati sa nuk u ndamë. Si pasojë e këtij problemi shumë gjëra janë ftohur mes meje e burrit. Duke i ditur aftësitë tua, dua të di se a ka pasur burri diçka me motrën time dhe a ka ende

apo realisht i kanë ndërprerë të gjitha... Motra jeton ende te babai e një fejesë e ka prishur. A ka pasur lidhje prishja e fejesës së saj me burrin tim?

"E humbura"

Përgjigje:

Situatat njerëzore u përngjajnë sëmundjeve klinike. Te ju janë ftohur shumë marrëdhëniet me burrin, por gjërat nuk kanë vdekur. Kjo është shpresa më e madhe që të mban ty lidhur me të ardhmen. Këto çka kanë ndodhur do të kalojnë dhe nuk do të thyhet asgjë te ju pasi ju jeni familje.

Nuk shoh se kanë pasur diçka më shumë se biseda telefonike dhe në internet. Nuk shoh se gjërat kanë kaluar deri në përjetësi. Shoh se kanë pasur komunikim normal dhe motra jote, së pari, i ka kërkuar atij t'i ofrojë ndonjë rast për martesë dhe të vjen te ju, pra jashtë shtetit.

A do të kem fat me personin që jam në lidhje?

Zonjë, jam 32-vjeçare, nënë e tre fëmijëve. Me burrë jam ndarë. Kam një lidhje me një person nga Gjilani dhe kemi folur për mundësinë e mar-

tesës, sepse atij i ka vdekur gruaja, së paku kështu thotë, por ende asgjë nuk kam vërtetuar.

Të lutem, emrat mos i publiko, por vetëm ma kthe përgjigjen... A do të kemi martesë? A do të preket familja ime, sepse po më thonë se i kam fëmijët dhe nuk duhet të bëjë martesë të re? A është gjendja e personit tim realisht sikur më ka thënë ai apo jo?

"Gjilani"

Përgjigje:

Nuk shoh se ke për të bërë martesë me atë person. Ka shumë gjëra që nuk t'i ka thënë haptazi, por edhe ti ke gjëra që nuk ia ke treguar atij.

Shoh se në mes jush ka shumë fshehtësi dhe fëmijët tu janë larg mundësive që të bashkohen me atë familje. Nuk shoh se mund të keni ndonjë kombinim martesor të lumtur, prandaj mos i hyj kësaj ideje. Ti e do atë person, por kjo nuk garanton se fëmijët tu do ta duan atë njeri sikur e imagjinon ti.

Shoh se po i zgjeron problemet, prandaj mos e publiko lidhjen...

Pse vëllezërit nuk janë rehat?

Qoftë e gëzuar kjo ditë që po u shkruaj motër e bekuar! Jam një zonjë që jetoj jashtë Kosovës, vendlindja ime është Hasi i Prizrenit. I kam tre vëllezër që nuk janë rehat në shtëpi. Sa herë shkoj bëhet zhurmë e madhe për asgjë. Kushtet i kanë shumë të mira për të jetuar dhe punojnë që të tre.

Gratë e tyre më thonë se gjendja nuk është problematike vetëm kur unë jam aty, por

edhe kur nuk jam... Grinden mes vete qe një vit... Po dys-hojmë se kemi të këqija në shtëpi...

Kemi qenë familje që e kemi urryer shumë zhurmën. Kemi qenë familje me të gjitha të mirat dhe me rehati, por tash kemi shumë probleme... Të lutem, na ndihmo që ta kalojnë këtë problem!

"Pa shifër"

Përgjigje:

Ju jeni jashtë, por duhet ta mbani nën kontroll edhe shtëpinë në vendlindje. Nuk jeni rehat, sepse te dhoma nga rrushi duhet të kontrollohet çdo gjë dhe do të gjeni gjëra të dyshimta që janë keqbërje dhe magji.

Posa t'i largoni ato gjëra nga shtëpia ju do të rehatoheni dhe vëllezërit më nuk do kenë probleme të tilla sikur i kanë tani.

A do të kem fat për të lindur?

Përsëndetje zonja magjistare, jam një zonjë, 36-vjeçare, jetoj në Kamenicë. Kam pasur tri abortime dhe pastaj tri vjet nuk kam mbetur më shtatzënë. Pas konsultimeve me ty, më në fund, kam mbetur shtatzënë që nëntë javë.

Shumë po frikësohem se po e humbas edhe këtë shtatzëni, prandaj dua t'më thuash se a kam shpresa dhe a do të arrij të kem në prehër fëmijën tim...

"Dua fëmijë"

Përgjigje:

Kjo shtatzëni shoh se do të shkojë deri në fund dhe do të arrish të bëhesh nënë. Vetëm muajin e fundit preferoj ta kalosh në spitalin gjinekologjik dhe do të kesh rezultate. Më në fund, do

të buzëqeshë fati të keni vajzë e pas dy vjetësh edhe djalë.

A do t'më paraqitet ish-i dashuri, apo ka gjetur tjetër?

Ju përsëndes nga zemra magjistare e nderuar! Jam 24-vjeçare, kam kaluar me një djalë 8 muaj. Ai jeton në Zvicër dhe dy herë që ka qenë në pushim kemi folur si të vijnë te fejesa. Ai nuk i kishte familjen këtu dhe e lamë që në mesin e muajit gusht të fejohej. Por, ai nuk erdhi...

Por, edhe gjërat kanë ndryshuar shumë mes nesh, sepse më nuk më flet si dikur. Nuk di çka po ndodh me të! Familja ime e dinë se e kemi lënë të fejohej dhe kam rënë në hall se nuk po di çka t'u them si arsyetim... Të lutem, a do të kem fejesë se jam në stres të madh?

"Frika nga dashuria"

Përgjigje:

Nuk po më del se do të keni fejesë. Në fakt, as nuk ka qenë ai për t'u fejuar me ty dhe as që e ka folur këtë punë me familjen e tij. Ai të ka bërë lajka dhe nuk ta ka thënë të vërtetën, por ti ke humbur shumë nga ajo lidhje e premtimeve. Është një gabim që e përsërisin zakonisht vajzat, duke menduar se po përfitojnë nga djali që ka letra jashtë, por jo gjithnjë kjo ka efekt.

Pse u prish fejesa ime?

Zonja magjistare, u përsëndes shumë dhe ndihem e emocionuar që po u shkruaj. Jam 26-vjeçare, e bukur. Jo vetëm unë mendoj kështu, por të gjithë ma thonë një gjë të tillë. Të fejuarin e kam dashur

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: "Kosovarja", fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

shumë dhe besoj se edhe ai mua më ka dashur, por përnjëherë ndodhi diçka e keqe. Ai mori vendim të prishë fejesën, edhe pse unë nuk e di nga i erdhi ideja...

Familja ime vazhdimisht më fajësojnë mua për këtë problem...

Pse ndodhi kjo? A do të kthehet t'më kërkoj?

"E pikëlluara"

Përgjigje:

Realiteti është se ti i ke treguar atij për ofertat tua të mëdha që ke akoma, edhe pas fejesës. Dhe, ky tregim i vazhdueshëm që ke bërë ti, e ka zgjuar atë nga gjumi për të kuptuar se ti do të kërkoresh te ai privilegje. Kjo i bie sikur ti ke dashur t'i thuash se unë jam e bukur dhe ti duhet të pajtohesh me mua për çdo gjë siç them unë.

Dhe, duke mos qenë të barabartë nga pamja e jashtme, ai me sugjerimin e familjes ka vendosur ta prishë fejesën, sepse i është frikësuar të ardhmes me ty. Gabimi vendimtar që ke bërë është kur keni qenë të ftuar në një dasmë dhe ti nuk ke shkuar me të, por ke shkuar në ahengun tjetër te shoqja jote. Me këto gjeste ke treguar se nuk e ke përfillur të fejuarin, ndërkohë që ai ka qenë shumë i përkushtuar për ty, madje duke i plotësuar kërkesat tua dhe të familjes sate.



SHERWOOD

Resorts and Hotels



feel the legend

SHERWOOD
exclusive kemer

SHERWOOD
exclusive lara

SHERWOOD
Dreams Resort

3UE
TUI BLUE
Belek

SHERWOOD
Suites Resort

SHERWOOD
Greenwood Resort

SHERWOOD
Premio Hotel

www.sherwoodhotels.com.tr

[@sherwoodresorts](https://www.instagram.com/sherwoodresorts)